“Islami ka filluar i huaj dhe do të kthehet i huaj, ashtu siç ka filluar, andaj lum për këta të huaj!”

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Islami ka filluar i huaj dhe do të kthehet i huaj, ashtu siç ka filluar, andaj lum për këta të huaj!”

[Sahih] [Transmeton Muslimi]

Profeti ﷺ në këtë hadith tregoi se Islami nisi si diçka e huaj, me pak njerëz që e pranuan atë, dhe do të kthehet si diçka e huaj, me vetëm pak njerëz që do ta mbajnë atë, ashtu siç nisi. Pra, përgëzime të mëdha dhe lajme të mira për të huajt, si dhe lumturi e kënaqësi për ta.

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/66219